



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në mbështetje të nenit 28 paragrafi 1.2, nenit 29 paragrafi 1, nenit 54 paragrafi 1.9, nenit 3 paragrafi 1.8, nenit 35 paragrafi 5, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës nr. 03/L-229 (Gazeta Zyrtare nr.88/25), nenit 18 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-028 (Gazeta Zyrtare nr. 08/01), në mbledhjen e mbajtur më 24.04.2017 mori në shqyrtim kërkesën nga "Viva Fresh Store" sh.p.k. në Suharekë të pronarit z. Xhevdet Rexhepi, me nr. prot. 55/16-01 të datës 26.05.2016 kundër Komunës së Suharekës - Drejtorisë për urbanizem, planifikim e mjedis dhe Zyrës së kryetarit të Komunës, për të konstatuar shkeljen e konkurrencës së lirë dhe nxjerrë këtë:

KONKLUZION

1. Konstatohet se kërkesa e dorëzuar nuk është në kompetencën e Komisionit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
2. Komisioni konstaton se lënda me nr. të protokollit: 55/16-01 e datës 26.05.2016 merr epilogun sikur në pikën 1 të këtij dispozitivi dhe
3. Rasti konsiderohet i mbyllur.

ARSYETIM

Pronari i "Viva Fresh Store" sh.p.k. në Suharekë ka bërë kërkesën e regjistruar me nr. të prot. 55/16-01 me datë 26.05.2016, me të cilën kërkon konstatimin e shkeljes së konkurrencës së lirë, nga ana e Komunës së Suharekës – Drejtoria për urbanizem, planifikim e mjedis dhe Zyra e kryetarit të Komunës.

Kërkesa është në lidhje me dhënien e pëlqimit për hapjen e pikës së shitjes me pakicë - qendër tregtare, sipas standardeve të qendrave tjera të hapura në Kosovë, në pronën të cilën e ka në qirambajtje "New Co Ballkan". Konstatohet se kërkesa si e tillë nuk është në kompetencën e Komisionit, por në kompetencën e Kuvendit Komunal të Suharekës dhe ky rast merr epilogun si ne dispozitiv të këtij KONKLUZIONI.

Këshilla juridike:

Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të inicioj konfliktin administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative .


Me këtë KONKLuzion të njoftohen:


- Arkiva dhe
- "Viva Fresh Store" sh.p.k. Suharekë


**KOMISIONI I
AUTORITETIT KOSOVAR TE KONKURRENCES**


Valon Presheh
Kryetar


Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar


Fatime Haziri
Anëtare


Muhamed Krasniqi
Anëtar


Shaqir Morina
Anëtar